

VENDIM
Nr. 910, datë 18.11.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË KONVIKTIT TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “KOLIN GJOKA”, BASHKIA LEZHË DHE KAKTIMIN E BASHKISË LEZHË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë, në vlerën 155 000 000 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milionë) lekë.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë, të jetë në vlerën 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekë dhe të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit.

3. Kaktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë.

4. Fondi për financimin e rindërtimit të konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë, i transferohet njësisë zbatuese, Bashkisë Lezhë.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama